

AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË  
"LUXOLITE COMMUNICATIONS " SH.P.K.

Sot, me 13/06/2018 , ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "LUXOLITE COMMUNICATIONS" Sh.p.k

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Klaudio Haxhiri** i biri i Perparimit i datelindjes 21.10.1996 shtetas Shqiptar me numer identifikimi nr:J61021050T lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane ne adresen Rr.Valentina Pistoli,nr. 2 kati 1.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit", kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar "Luxolite Communications " SH.P.K , duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

**NENI 1**

**EMËRIMI DHE LLOJI I SHOQËRISË**

Shoqëria e formuar do të emërohet " LUXOLITE COMMUNICATIONS " Sh.p.k

**NENI 2**

**SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane, Tirane, Njesia Administrative Nr.5 ,Rr.Hasan Halla, Komuna e Parisit.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

**NENI 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**



Ne fushen e Telekomunikacionit: Qender Telefonike, Nderlidhje, Marketing Online.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

#### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,000 Lekë (njemije) Lekë. Kapitali themeltar përbëhet nga 1 kuota me vlerë nominale 1,000 Lekë (njemije), dhe është paguar e zoterohet nga ortaku si vijojn:

- **Z.Klaudio HAXHIRI** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### NENI 6

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor të pakufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

#### NENI 7

#### ADMINISTRIMI I FITIMEVE

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakëve themelues.

Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

#### NENI 8

#### ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.



Administratori i shoqërisë do të jetë - - - **Klaudio Haxhiri** i biri i Perparimit i datelindjes **21.10.1996** shtetas Shqiptar me numer identifikimi nr:J61021050T lindur ne Tepelene dhe banues ne Tirane ne adresen Rr.Valentina Pistoli,nr. 2 kati 1.

#### **NENI 9**

#### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

#### **NENI 10**

#### **MARDHËNIET E PUNËS**

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendeshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **NENI 11**

#### **KONFIDENCIALITETI**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

#### **NENI 12**

#### **PJESËMARRJA NË SHOQËRI OSE AKTIVITETE TË TJERA**



Ortakët e shoqërisë nepermjet Asamblese se Pergjithshme mund të vendosin për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera, futjen e personave të tjerë si ortakë të shoqërisë dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkurues me atë të shoqërisë së themeluar prej tij.

#### **NENI 13**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **NENI 14**

#### **LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrijë një bilanc likuidimi për miratim.

#### **NENI 15**

#### **EKSPERTËT DHE REVIZORËT KONTABËL**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizor kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

#### **NENI 16**

#### **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

Veprimtaria ekonomike vjetore e shoqërisë do të mbyllet në datën 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatit ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakut të vetëm dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

#### **NENI 17**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**



Akti Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

***ORTAKET***

***E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***“LUXOLITE COMMUNICATIONS”***

**Klaudio Haxhiri**

Klaudio Haxhiri

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Klaudio Haxhiri', written over a horizontal line. The signature is stylized and includes a circular mark at the beginning.